

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot, më datë **10/08/2020** palët pjesëmarrëse kanë rënë dakort për lidhjen e kontratës së mëposhtme:

PALËT PJESMARRËSE NË KONTRATË :

Elvis Burhan Leva, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me nr. personal identifikimi I30716074J, lindur më 16.07.1983 në Shkoder e banues në Tiranë.

(Këtu më poshtë referuar si "Shitësi")

Dhe

Leandro Ferdinand Skuteri, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me nr. personal identifikimi I21121070I, lindur më 21.11.1982, në Shkodër, Shqipëri, me adresë banimi në Tiranë. (Këtu më poshtë referuar si "Blerësi")

Neni 1


Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është shitja 100% (njëqind përqind) e kapitalit të shoqërisë të cilat zoterohen nga Znj. Elvis Leva, dhe që do të përfaqësojë një kuotë ne shoqërine "**Vale Group**" Shpk me numër unik NUIS: **L81507047R** me adresë të saj **Tiranë, Rr."Durrësit"** ("**Dritan Hoxha**"), apartamenti me nr.pasurie **2/397/ND1+1-1, vol 20, faqe 37, zona kadastrale 8210, kati i pare.**

Neni 2

Cmimi

Cmimi i shitjes së 100% të kapitalit të shoqërisë e cila përfaqëson 1 (një) kuotë të vetme në kapitalin e shoqërisë "**Vale Group**" Shpk është 100 (njëqind) lekë.



Neni 3

Afati i pagimit te cmimit

Pagimi i cmimit do të kryhet pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e shitesit

1. Shitësi ka të drejtë të kërkojë nga blerësi pagimin e çmimit ne mënyrën dhe afatin e parashikuar në këtë kontratë.
2. Shitësi është i detyruar t'i dorëzoje blerësit të gjithë dokumentacionit që shënon të drejtën e pronësisë dhe që janë të nevojshme për kalimin e saj.
3. Shitësi duhet të garantojë blerësin për gëzimin e qetë të kuotave nga çdo e drejtë pronësie të personave të tretë. Shitësi është i detyruar të marrë pjesë në gjykim në mbështetje të blerësit nese ai thirret prej tij, për ta garantuar ndaj pretendimeve te personave te trete, mbi kuotat objekt i kontrates.

Neni 5


Te drejtat dhe detyrat e bleresit

1. Bleresi ka të drejtë te kërkojë dokumentat qe vërtetojnë pronësinë e shitësit mbi kuotat, objekt kontrate nga shitesi nga e nesermja e hyrjes ne fuqi të kësaj kontrate.
2. Bleresi eshte i detyruar të marrë në zotërim vendin ku shoqëria Vale Group ka qëndrën e ushtrimit të aktivitetit.

Neni 6

Zgjidhja e kontratës

1. Shitesi ka të drejtë të kërkojë të zgjidhe kontraten kur:



- a) blerësi nuk paguan cmimin.
- b) blerësi nuk merr në dorëzim objektin ku shoqëria ushtron aktivitetin , brenda 15 ditëve nga afati shtesë i caktuar nga shitësi;
- c) blerësi nuk merr në dorëzim dokumentat e pronësisë së kuotave

2. Bleresi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur:

- a) shitësi nuk dorëzon dokumentat e pronësisë së kuotave
- b) shitësi nuk dorëzon objektin e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë, objekt kontrate brenda afatit shtesë 10 ditor, të caktuar nga blerësi ;
- b) shitësi deklaron brenda afatit 10 ditor se nuk do të dorëzojë dokumentacionin dhe objektin e ushtrimit të aktivitetit;

Neni 7

Pasojat e zgjidhjes se kontrates

1. Shitësi me zgjidhjen e kontratës duhet t'i kthejë pagesat e bëra blerësit, dhe gëzon të drejtën për shpërblimin e dëmit .

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast mosmarrëveshje midis tyre palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim, dhe vetëm kur një gjë e tillë është e pamundur ato do t'i drejtohen gjykates se "Rrethit Gjyqësor Tiranë".

Neni 9

Shpenzimet per lidhjen e kontratës

Shpenzimet për lidhjen e kësaj kontrate i ngarkohen te dyja palëve përkatësisht.

Neni 10

Momenti i kalimit të pronësisë dhe Hyrja në fuqi

Kuota zotëruese në shoqërinë “Vale Gorup” Sh.p.k. kalon në pronësi të Leandro Skuteri në datën 10/08/2020. Kjo kontratë hyn në fuqi në datën 10/08/2020.

Neni 11

Hartimi i kontratës

Kjo kontratë u hartua në 3 (tre)kopje nga një për secilën palë.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSI

Elvis Lera



Elvis Lera

BLERËSI

Leandro Skuteri

